




PËRFAQËSUESIT E SË ARDHMES



DEMOKRACIA NË JETËN TONË

ALBINA (14), ERMONDA (13), HASAN (14), RIJON (14), DONITA (13), ERBLINA (14), DAFINA (14)



Barazia, liria dhe bashkëpunimi janë disa nga parimet e demokracisë. Për ta kuptuar këtë më mirë, lexojeni artikullin

Një botë ku nuk ka padrejtësi. Një botë ku nuk ka luftëra. Një botë ku ka paqe dhe barazi. Një botë e mbushur me humanitet dhe tolerancë. Kjo botë është demokracia. Një botë e madhe që i hap dyert për të gjithë njerëzit pa dallime. Demokracia është një dhuratë që njerëzimi ia ka bërë



vetes që nga viti 507 p.e.s. atëherë ku demokracia lindi për herë të parë në kryeqytetin e Greqisë në Athinë. Që nga atëherë, njerëzit kanë hapur rrugën për një ndryshim. Ndryshim ky që ka vazhduar edhe sot. Gjërat e çmuara siç është demokracia duhet ruajtur, sepse është thesari i përbashkët i të gjithë neve. Prandaj, duhet ditur si ta ruajmë. Këtë mund ta bëjmë duke respektuar dhe duke jetuar në bazë të vlerave dhe elementeve të kësaj udhëheqje. Këto elemente

janë: toleranca, paqja, respekti, barazia, solidariteti, etj. Nëse ne i respektojmë këto elemente, do të kemi një botë siç e përmendëm më lart. Botë të mirë për të gjithë ne.

Demokracia ka llojet e saj, ato janë demokracia e drejtpërdrejtë (populli merr vendime përmes referendumeve) dhe demokracia përfaqësuese (popull zgjedh përfaqësuesit me anë të votës). E drejta e votës, e shprehjes së mendimit, e drejta e shkollimit janë vetëm disa nga të drejtat që ne i gëzojmë si popull demokratik. E si mund t'ia mohojmë njëri-tjetrit këto të drejta? Kjo nuk duhet të ndodhë asesi.


Ne, në shkollën tonë jemi të gjithë shokë dhe e përkrahim njëri-tjetrin, pavarësisht që në shkollën tonë ka persona, të cilët u takojnë feve të ndryshme. Për neve, kjo nuk ka rëndësi. Rëndësi ka që të gjithë jemi të barabartë. Nëse nuk kemi demokraci, nuk kemi as shtet. Kurse, pa shtet të mirë nuk ka jetë të mirë.



Autorët e këtij artikulli

NDARJA E PUSHTETIT

GETUARTA (14), ELDIONA (13), DONIKË (14), FATIME (14), EROLINDA (14), GZIM (14), PASHTRIK (14)



Nuk ka gëzim më të madh kur të gjithë qytetarët ndihen të barabartë me njëri tjetrin, e kjo ndodh kur ka Ndarje të Pushtetit

Një demokraci e mirëfilltë nuk mund të paramendohet pa Ndarjen e Pushtetit. Për ta kuptuar arsyen se pse ndodh kjo, mos iu ndani artikullit...

Një shtet është demokratik, kur ai qeveriset prej përfaqësuesve të popullit, të cilët ushtrojnë pushtetin në emër të këtij të fundit dhe pa dyshim që marrin vendime në të mirën e popullit. Ndarja dhe balancimi i pushtetit përbën parimin kryesor të shtetit të së drejtës në vendet demokratike dhe moderne. Kur jemi të shteti i së drejtës, ne sot mësuam se cilin shtet mund ta quajmë kështu. Shtet i së drejtës është një shtet, ligjet e të cilit janë në përputhje me parimet kushtetuese dhe që nuk mund të ketë shtet funksional pa ndarjen e pushtetit. Ndarja e pushtetit është elementi bazë i demokracisë moderne që parashihet edhe me nenin 4 të Kushtetutës së Kosovës. Sepse këtu, përgjegjësia është e barabartë mes institucioneve, ashtu siç edhe ne qytetarët jemi të barabartë me njëri-tjetrin. Pra, kur një shtet është demokratik, ai pa dyshim që ka edhe ndarje të pushtetit, në mënyrë që mos të abuzohet fuqia e një pushteti. Pushteti në Kosovë ndahet në tri degë: në Pushtetin Legjislativ, Ekzekutiv dhe atë Gjyqësor. Pushteti Legjislativ ushtrohet nga Kuvendi, i cili bën miratimin e ligjeve, ligje këto që janë në të mirën tonë, si ligji për familje, ligji për arsim, ligji për të drejtat e fëmijëve, etj. Pushteti Ekzekutiv ushtrohet nga Qeveria, e cila ka për detyrë të vë në funksion lig-

jet e miratuara nga Kuvendi. Si dhe Pushteti Gjyqësor, i cili ushtrohet nga gjykatat, qëllimi i të cilave është që këto ligje të miratuara të zbatohen nga të gjithë qytetarët e Kosovës dhe të mos shkelen. Të tri degët e pushtetit kanë një qëllim të përbashkët, mirëqenien e të gjithë qytetarëve. Nga kjo që u cek më lart, kuptojmë që ndarja e pushtetit ka lidhje të ngushtë me demokracinë. Mënyra se si erdhëm në këtë përfundim ishte shembulli që morëm brenda grupit të vogël, kur shoku ynë Pashtriku ishte në vendin e mbretit dhe ai na urdhëronte të bënim gjëra pa dëshirën tonë. Shoku ynë e kishte pushtetin dhe nuk na trajtonte të gjithë barabartë, por e abuzonte atë. Ndërsa, kur vendosëm që secili prej nesh të ketë përgjegjësitë e veta, atëherë rezultati i punës së grupit ishte dukshëm më i mirë, por po ashtu edhe anëtarët e grupit ishin më të lumtur. Përgjegjësia na ndihmon të rritemi dhe të jemi më të përgjegjshëm në punën tonë.



Ne jemi autorët e artikullit të Ndarjes së Pushtetit

ARDHMËRIA ËSHTË NË DUART TONA

PASHTRIK (14), ANDI (14), RINITI (14), ERLINDA (14), EDISONA (14), ZADE (13),
FATJONA (14), MIRZANA (14)

Për të kuptuar rëndësinë e zgjedhjeve në demokraci ju ftojmë që ta lexoni artikullin tonë


Njeriu që nga lindja ka të drejtën e të qenurit i lirë. Të gjithë gëzojmë shumë të drejta si: të drejtën e shkollimit, edukimit, lojës dhe plot të drejta të tjera të cilat na i mundëson demokracia. Gjatë gjithë jetës sonë ne ballafaqohemi me zgjedhje të ndryshme. Prandaj, nga të gjithë qytetarët kërkohet që të jenë të përgjegjshëm për vendimet që i marrin.

Secili prej shtetasve të Kosovës ka të drejtën e votës në procesin zgjedhor, por me kusht që ai/ajo të ketë moshën mbi 18 vjeçare, sepse atëherë ai/ajo është më i/e pjekur. Vota ka shumë rëndësi për vendin tonë. Për shembull, përmes votës populli i zgjedh deputetët dhe pastaj ata bëjnë ndryshimin për ne.

Ne kemi një mesazh për ju të dashur lexues: ne kemi ndikim shumë të madh në vendimet që i marrim. Kështu pra, vota jonë është ardhmëria jonë.




Shkrimtarët e demokracisë



Të jetosh në demokraci



Të bashkuar shkojmë përpara



Përfaqësuesit e vendit



Vota ime vlen



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Fehmi Agani“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: IX-2
Website: www.demos-ti.org Vendi: Turjakë, Malishevë

Kjo kopje nuk është e redaktuar nga Kuvendi i Kosovës